



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2018, ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Futja në rendin e ditës së shqyrtimit të kërkesës së AMA-s për lirimin nga detyra të anëtarit të AMA-s, Zylyftar Bregu, për shkelje të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar””.
2. Seancë dëgjimore me universitetet publike të Tiranës në kuadër të diskutimit të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Kejdi Mehmetaj.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Fillojmë mbledhjen e radhës së komisionit!

Vazhdojmë me dëgjuesat për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”.

Rendi i ditës së sotme ka një ndryshim nga ai që kemi miratuar më parë. A jeni dakord me vendosjen si pikë të parë të tij, shqyrtimin e një shkrese që na vjen nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura të Kuvendit? A jeni dakord për të bërë këtë ndryshim?

Para se të fillojmë, unë desha t’i jap fjalën zotit Ylli për të bërë një konfirmim të kuorumit që kemi në komision.

Fidel Ylli – Kuorumi është i plotë. Mund ta vijojmë normalisht mbledhjen.

Milva Ekonomi – Jam vënë në dijeni nëpërmjet një shkrese të ardhur nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, se zoti Gentian Sala, kryetar i AMA-s, ka dërguar një shkresë për Kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë, zotin Ruçi, për lirimin nga detyra të një anëtar i AMA-s, zotit Zylyftar Bregu, me arsyetimin se ky anëtar, në kundërshtim me detyrimin kushtetues për ushtrimin e mandatit, në përputhje dhe në zbatim të ligjeve në fuqi, në kundërshtim të ligjit organik për AMA-n, në shkelje të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” dhe në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, ka përfutur nga një kontratë qiraje të lidhur më 2 korrik 2015.

Kuvendi i Shqipërisë, sekretari i Përgjithshëm i tij, ka bërë veprimet paraprake, duke vënë në dispozicion të gjithë protokollin e mundshëm për të sqaruar nëse kjo kontratë, e cila është marrë nga një burim mediatik, ishte e vërtetueshme apo jo. Sot kemi para nesh një shkresë të sjellë nga sekretari i Përgjithshëm, ku kërkohet të ndërmarrim disa hapa në zbatim të Rregullores. Hapat që duhet të kemi në konsideratë lidhen me faktin që kemi një ligj nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, kemi edhe ligjin nr. 9367 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar”, si dhe Rregulloren e Kuvendit. Në këto kushte, si komision përgjegjës, në zbatim të ligjit 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ne e vlerësojmë nisjen e procedurës disiplinore për trajtimin e rastit në kushtet e shkeljes së ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar”. Për këtë arsye unë mendoj që me ardhjen e kësaj shkrese nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit në komisionin tonë, të biem dakord që të

thërrasim në një dëgjese paraprake zotin Bregu, para marrjes së çdo vendimi, që ai të na shpjegojë rastin në fjalë.

A jeni dakord që ne ta thërrasim në dëgjese zotin Bregu?

Miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e dytë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të zhvilluara në datat 1 dhe 5 nëntor 2018.

Unë nuk e di nëse i keni parë, por unë personalisht i kam parë këto procesverbale. Në qoftë se keni nevojë për të bërë komente, e dini shumë mirë se si funksionon. Vërejtjet tuaja mund t'ia dërgoni me shkrim sekretares së komisionit dhe ato menjëherë do të përfshihen te procesverbalet.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2018, ora 11.10

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Seancë dëgjimore me universitetet publike të Tiranës në kuadër të diskutimit të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Besnik Baraj (deputet zëvendësues).

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Kejdi Mehmetaj.

Të ftuar:

Prof. Dr. Mynyr Koni – Rektor në Universitetin e Tiranës,
Prof. Dr. Arben Gjata – Rektor në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë,
Prof. Dr. Agron Cuka – Rektor në Universitetin e Sporteve "Vojo Kushi",
Mirlinda Galushi - administratore në Universitetin e Sporteve,
Mirela Bimo - drejtore e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MASR.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi - Sot kemi edhe një seancë dëgjimore në kuadër të diskutimit të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”, që lidhet me 2 kategoritë e universiteteve, me universitetet tona publike, të cilat janë të përqendruara në Tiranë dhe me universitetet publike, të cilat janë të përqendruara në rrethet e vendit. Në orën 11:00 kemi thirrur UT-në, Universitetin Politeknik, Universitetin e Mjekësisë, Universitetin e Arteve, Universitetin Bujqësor dhe Universitetin e Sporteve.

A jemi gati ta fillojmë dëgjesën me përfaqësuesit e universiteteve, që kanë konfirmuar ardhjen?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirëdita!

Mirë se keni ardhur!

Faleminderit shumë!

Sot kemi planifikuar të bëjmë një dëgjesë me ju në kuadër të diskutimit të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”. E kemi konstatuar edhe nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, që tashmë ju jeni njohur me të gjithë ecurinë e projektbuxhetit. Do të kishim nevojë të dëgjonim nga ju, pavarësisht nga instrumentet e planifikimit buxhetor që merr përsipër të informojë MASR-ja, se çfarë nevojash keni dhe se si e shikoni ju projektbuxhetin e vitit 2019.

Sipas radhës listën e dëgjesave e fillon zoti Mynyr Koni nga Universiteti i Tiranës. Nga Universiteti Politeknik i Tiranës nuk ka ardhur njeri. Më pas kemi përfaqësuesin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe atë të Universitetit të Sporteve, Tiranë.

Nga Universiteti i Mjekësisë ka ardhur një informacion me shkrim për projektbuxhetin, i cili është shpërndarë nga sekretaria. Universitetet e tjera nuk kanë sjellë paraprakisht ndonjë informacion me shkrim për projektbuxhetin, por duke ju pasur këtu, mund t’ju dëgjojmë me shumë vëmendje dhe të diskutojmë.

Faleminderit!

Fjala për ju!

Mynyr Koni – Faleminderit për ftesën tuaj në lidhje me diskutimin e projektbuxhetit për vitin 2019!

Në faqen zyrtare të Kuvendit unë e pashë me shumë kujdes këtë projektligj dhe tabelat përkatëse, që kanë të bëjnë me arsimin e lartë dhe me kërkimin shkencor, dy zëra të cilat mbulojnë fushën e aktivitetit të institucioneve të arsimit të lartë, ku bën pjesë edhe UT-ja.

Shqetësimet më të ndjeshme që ka UT-ja, besoj se edhe të gjitha IAL-të e tjetra në Shqipëri, janë, së pari, për fondet e pagave për personelin akademik dhe joakademik në IAL-të përkatëse. Aktualisht, ne po vijojmë me një grant që jep në fillim të vitit MASR-ja. Për këtë vit kemi edhe një VKM për mënyrën dhe modelin e financimit në IAL-të.

Një çështje substanciale që ne e kemi ndjerë vazhdimisht, është çështja e fondit të pagave. Transferta e grantit që i jepet universitetit nuk e përballon fondin e pagave, por shkon për rreth 9 muaj e gjysmë, së bashku me pagat edhe zëri 600 dhe ai 601. Sigurisht, kjo është një barrë e madhe për UT-në, për shkak të numrit të madh të personelit, të ngarkesës etj., dhe i bie që kjo pjesë e pagave të mbulohet nga të ardhurat dytësore, që krijohen nga UT-ja.

Një tjetër element shumë i rëndësishëm, është çështja e fondit të kërkimit shkencor. Me sa mbaj mend unë në vitin e kaluar, për këtë vit ky fond në këtë projektbuxhet është rreth 4 milionë euro ose rreth 5,2 milionë për mijë, siç është shprehur në tabelën përkatëse. Nuk e di si i bie me vlerat në lekë shqiptare.

Ajo që ne na shqetëson si IAL, është çështja e inicimit të programeve të doktoraturave. Aktualisht, jemi në një situatë ku ligji i ri ka ndryshuar modelin për hapjen e programeve të doktoraturave. Tani bëhet në kuadër të projekteve kërkimore, të cilat iniciohen nga stafet akademike, nga profesorët e nderuar dhe pasi marrin financimin në kuadër të fondit të kërkimit shkencor, atëherë shpallen edhe kuotat dhe zhvillohet programi i doktoraturave. Kjo është arsyeja pse ne jemi pak të frenuar në këtë moment për rivitalizimin e shkollës së doktoraturës, cikli i tretë. Aktualisht për vitin përkatës, për vitin 2018, një fond i tillë i dedikuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor nuk është vënë në dispozicion, veçse është shpallur projekti kombëtar me disa fusha përkatëse, ku ne kemi aplikuar dhe shpresojmë që së shpejti të finalizohen edhe projektet e paraqitura nga universiteti. Kështu, do të kërkoja një sqarimin nga përfaqësuesit e MASR-së në lidhje me këtë moment, nëse është parashikuar që ky fond të jetë në dispozicion për IAL-të publike apo jopublike në kuadër të projekteve për doktoraturën, në mënyrë që ne menjëherë të marrim masa dhe të shpallim thirrjen që profesorët të paraqesin projektet për të hapur ciklin e doktoraturës.

Së dyti, do të doja të dija përsëri, meqenëse vlera aty është në makro dhe ne nuk mund ta parashikojmë se sa është parashikuar të jetë granti që mendohet të shpërndahet tek IAL-të, nuk flas vetëm për UT-në, se ky është problem i përgjithshëm, nuk është vetëm për UT-në, në raport me mbulesën vjetore të personelit akademik.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Mirela, meqë je këtu, mund të përgjigjesh për pyetjet që bëri zoti Koni. Unë mendoj që t'i dëgjojmë pretendimet e tri universiteteve për buxhetin dhe, më pas, t'u përgjigjeni pyetjeve sipas kompleksitetit të çështjeve.

Urdhëroni, zoti Gjata!

Arben Gjata – Faleminderit për ftesën!

Ne jua kemi dërguar me shkrim problematikat që kemi, siç na i kishit kërkuar. Faktikisht, problematikat e universiteteve janë të ngjashme. Ne vazhdojmë të kemi të njëjtin problem që ka pasur edhe UT-ja, për sa i përket grantit të pagave. Ligji parashikon që një pjesë e këtij granti shkon për mbështetjen e kërkimit shkencor, për politikat e zhvillimit të institucionit etj., por faktikisht grantet historikisht janë përdorur vetëm për të mbuluar pagat, pasi nuk i mbulojmë dot pagat. Edhe këto ne i mbulojmë më shumë se UT-ja, meqenëse kemi një numër më të madh pedagogësh në raport me studentët. Mbeten pa u mbuluar të gjitha shpenzimet e tjera për orët jashtë orarit, për pedagogët e jashtëm dhe një pjesë e pagave, mbulohen nga të ardhurat dytësore, që krijon universiteti, gjë që shpeshherë na vë vërtet në vështirësi financiare.

Problemi i dytë që kemi është ai me udhëzimin e ri, i cili parashikon një normë tjetër pedagogjike për mbulimin e pagesës së pedagogëve gati 200% për orët jashtë orarit, qoftë për pedagogët e brendshëm, qoftë për ata të jashtëm. Ne i kemi kërkuar ministrisë, meqenëse kemi disa specifika, të cilat kanë të bëjnë me procesin e mësimi të drejtuar që është te shtrati i pacientit, të na e ulin normën, pra të mos e quajë ngarkesën 1 me 1, një orë faktike me një orë pedagogjike, por ta quajë 0,5, në mënyrë që ta ulim ngarkesën tonë, sepse në të kundërt i bie që ne të falimentojmë si universitet, nëse do ta zbatonim. Besoj se kemi gjetur mirëkuptimin e ministrisë në këtë rast për një arsye shumë të thjeshtë, sepse në mjekësi, duke qenë me punë në grupe të vogla, jemi të detyruar që 1 pedagog të mos jetë me 150 studentë, por të jetë me 12 studentë. Kemi futur edhe një koncept të ri, atë të mbikëqyrësit klinik. Kur i çojmë studentët nëpër spitale për të përfituar aftësimin klinik të tyre, t'i marrim si mbikëqyrës klinikë të gjithë

mjekët që punojnë në spitalet universitare, duke u paguar një sasi të vogël parash, në një përqindje më të ulët, një shpenzim financiar, të cilin po përpiqemi ta mbulojmë me fondet tona.

Gjithashtu, kemi një problem tjetër, i cili është më shumë problem ligjor sesa problem i këtij komisioni. Në kuadër të krijimit të të ardhurave alternative, që duhet të krijojë IAL-ja, sepse parimi i ligjit të ri për arsimin e lartë është që IAL-ja të hyjë në treg dhe të nxjerrë para nga tregu. Në kuadër të kësaj ne kemi menduar të bëjmë projekte, që të ofrojmë programe të edukimit në vazhdim qoftë për mjekët, qoftë për personelin mjekësor apo këdo tjetër në RSH.

Kemi rënë dakord me Ministrinë e Shëndetësisë që për një pjesë të projekteve që ata mund të kenë nevojë, ne mund t'i mbështesim me përgatitjen e projekteve të tjera.

Kemi një problem ligjor të rëndësishëm, se pjesën e stafit që do të marrë pjesë, ne nuk e paguajmë dot. Në qoftë se ligji parashikon që maksimumi mund t'i japësh shpërblim një rrogë vjetore shpërblim, njerëzit nuk kanë asnjë interes të përfshihen në këto projekte apo programe të edukimit në vazhdim apo në mbështetjen e projekteve, në qoftë se ne nuk i paguajmë. Ky do të ishte një handicap, i cili duhet zgjidhur, sepse nëse i paguajmë dhe vjen KLSH-ja na e quan shkelje.

Momenti tjetër, ka të bëjë me faktin që ne kemi pasur për shkak të disa fenomeneve, të cilat nuk kanë pasur lidhje me universitetin, por kanë pasur lidhje me mosekzistencën ose me bllokimin e bordit për një kohë të gjatë para 2 vjetëve. Buxheti i para 2 vjetëve u aprovua shumë vonë, u shpenzuan paratë dhe nuk pati mundësi të plotësoheshin investimet e tjera për shkak të atyre problemeve, që ju i dini: krijimi i bordit, bllokimi i tij, erdhi një, iku një dhe bordi filloi të funksiononte në tetor 2017 dhe ne nuk patëm aftësinë fizike për t'i plotësuar këto. Kështu, na kanë mbetur disa para në bankë. Ne do të kërkonim (një nga kërkesat që është vënë aty), është që këto para t'i universiteti t'i përdorë sipas kërkesave të veta dhe të mos bëhet ristrukturim i të ardhurave që ka siguruar universiteti ynë nga MF-ja. UMT-ja kërkon që granti i akorduar në vitin pasardhës të mos ristrukturohet nga Ministria e Financave dhe të mos kushtëzojë fondin e grantit të vitit 2019. Teprica në fund të vitit e pashpenzuar e grantit, nuk vjen nga mungesa e nevojave për shpenzimin e tij. Duhet të jetë vetë universiteti me planet e veta që të vendosë se ku, për çfarë dhe si do t'i përdorë paratë, sepse ne kemi ndërmend të bëjmë një projekt shumë madhor. Po përpiqemi të gjejmë mbështetje financiare qoftë nga buxheti, qoftë nga të ardhurat tona, qoftë nga donatorët e huaj. Ky projekt ka të bëjë me ngritjen e Qendrës së Simulimit Klinik. Shkurtimisht, ky projekt po bëhet, sepse te ne mjekët dhe infermierët mësojnë

te pacientët. Pra, edhe gjilpërat, edhe qepjet, edhe intubimet, edhe vendosjet e sondave i praktikojnë te pacienti. Kjo nuk ndodh, nuk është as etike, as plotësisht e sigurt, pavarësisht se bëhet në mbikëqyrjen e mjekëve. Ne donim të krijonim Qendrën e Simulimit Klinik, që ka të bëjë me blerjen e disa mulazheve, në mënyrë që studentët e mjekësisë para se sa të kalojnë te pacientët, të kalojnë një kurs trajnimi në mulazhe, në mënyrë që të mos ta shpojnë disa herë pacientin, se atij të shkretit i dhëmb. Kjo nuk është fort e këndshme qoftë për ata, qoftë për këta. Ne kemi prioritet këtë. Jemi duke u përpjekur dhe kemi planifikuar një pjesë të fondeve nga ana jonë, rreth 30 milionë lekë të rinj, por ndërkohë projekti, sipas llogarive të përafërta që janë bërë, shkon gati 2,6 milionë euro. Ne do të donim të gjenim mundësi. Ia kemi kërkuar edhe ministrisë, e kemi futur edhe në buxhetin afatmesëm të universitetit, si dhe faktikisht kemi bërë përpjekje edhe me donatorë të ndryshëm në qoftë se gjejmë mundësi.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zoti Gjata!

Vazhdojmë me Universitetin e Sporteve.

Zoti Cuka, na thoni diçka për nevojat që ka Universiteti i Sporteve lidhur me projektbuxhetin dhe në qoftë se keni kërkesa që mund t'i parashtroni tani, meqenëse përfaqësuesit e ministrisë i kemi këtu.

Agron Cuka – Së pari, ju falënderoj për ftesën që na keni çuar!

Unë nuk do të zgjatem shumë, pasi problematikat që kemi janë të njëjta me të universiteteve të tjera.

Për sa u përket pagave, ne i kemi plotësuar, nuk kemi pasur ndonjë problem të madh, madje këtë vit kemi marrë masa për të qenë më të kujdesshëm në planifikimin e ngarkesave, sipas udhëzimeve të reja që kanë ardhur, dhe të rregullojmë marrëdhëniet pedagog-student, si dhe disa veçori që kemi ne. Bie fjala, ashtu si Universiteti i Mjekësisë, edhe ne kemi grupe të vogla, pasi veçanërisht specialitetet sportive nuk mund të zhvillohen me numër të madh studentësh, siç përcakton ligji për universitetet e tjera, ku praktikat duhet të bëhen në grupe seminaresh prej 25-30 vetash. Duke qenë se është e pamundur që praktikat sportive t'i zhvillojmë në këtë numër, ne kemi një vendim të veçantë nga ministria që grupet tona të jenë më të vogla, sado që kjo sjell probleme në ngarkesa. Sidoqoftë, mund të them se jemi në rrugë të mbarë dhe këtë vit do t'ia dalim me sukses.

Për sa i përket problemit të doktoraturave, që e ngriti profesor Koni, pa dashur të zgjatem, kjo është një pengesë shumë e madhe për ne, pasi mosrealizimi në kohë i doktoraturave sjell edhe vonesën e marrjes së titujve shkencorë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor/doktor”, gjë që te ne ka krijuar një boshllëk: po na dalin në pension profesorët që kanë mbushur moshën tashmë dhe nuk po vijnë të rinj. Ka shumë vite që po përpiqemi në këtë sens, por ka disa probleme. Në qoftë se buxheti për kërkimin shkencor, ku do të përfshihen edhe doktoraturat, do të miratohet në kohë dhe do të na vijë sipas kërkesave që kemi paraqitur (rreth 40 kuota, në fakt, për doktoratura), ky do të ishte një favor shumë i madh për kualifikimin e punonjësve tanë.

Një nga problemet më të rëndësishme që kemi ne si institucion është investimi në infrastrukturë. Për shkak të disa ndërhyrjeve në ndërtimet e zonës, pasi ne jemi pjesë e ish-fushës së Aviacionit, institucioni ynë është kufizuar shumë, madje i janë prishur edhe ambientet sportive. Në këtë kuadër, ne kemi shumë nevojë për investime në infrastrukturë. Ky është problemi më i rëndësishëm që ne kemi tani, pasi besoj se këto të tjerat kanë hyrë në rrugë të mbarë dhe do të rregullohen. Mungesa e investimeve në infrastrukturë na prish cilësinë e punës, ndaj investimet në këtë drejtim do të ishin shumë të domosdoshme.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zoti Cuka!

Në fakt, nga dëgjesa juaj, pavarësisht nga problematika, unë nuk është se dëgjova një shifër. Ju e keni problematik atë aspekt, por nuk keni propozuar dot ndonjë shifër? A është negociuar shifra?

Agron Cuka – Atëherë...

Milva Ekonomi – Vetëm te zoti Gjata vura re një shifër, ndërkohë te diskutimi juaj...

Agron Cuka – ...ne na është prishur stadiumi. Kemi pasur një stadium të rregullt me fushë futbollit, pistë me gjashtë korsi e të tjerë, por nga ndërhyrjet e ndërtimeve e gjithë fusha apo i gjithë stadiumi është spostuar 20 metra dhe është cunuar shumë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prezente kemi administratoren dhe mund t’i thotë më qartë.

Vetëm fusha, me një projekt që është bërë, kushton 420 milionë lekë të vjetër, që i bie 42 milionë lekë të rinj. Përveç kësaj, kemi një projekt tjetër për të zgjeruar njërin nga palestrat, pasi është rritur shumë numri i studentëve dhe në palestrën e gjimnastikës që kemi mund të zhvillojnë

mësim vetëm një deri në dy grupe me ngushticë. Kështu që, na nevojitet ta zgjerojmë më shumë këtë palestër.

Ndonjë shifër konkrete mund ta thotë administratorja, në qoftë se mund t'ia jepni fjalën.

Milva Ekonomi – Domethënë, i keni gati shifrat dhe ndërkohë i keni të depozituara te Ministria e Financave.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe projektet janë gati.

Në rregull.

Unë them t'ua japim fjalën një herë përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit, për të na sqaruar pyetjet që bënë tre rektorët. Po ndonjë përfaqësues të Ministrisë së Financave kemi prezent?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull.

Fjalën e ka përfaqësuesja e Ministrisë së Arsimit.

Mirela Bimo – Faleminderit, zonja drejtuese e komisionit!

Buxheti i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, që është pjesë e buxhetit total të Ministrisë së Arsimit, le të themi se për vitin 2019 ruan trendin në rritje që ka pasur në vite dhe rritja është diku te 3,7% ose, përkthyer në vlera nominale, diku te 300 milionë lekë. Rritja kryesisht është si te programi i arsimit të lartë dhe i kërkimit shkencor, madje te programi i kërkimit shkencor rritja është më e konsiderueshme, duke pasur parasysh faktin që kërkimit shkencor po i jepet një fokus më i veçantë, porë kjo si nga kërkesat e universiteteve, por edhe nga detyrimet që ka vendi për anëtarësimin në Bashkimin Europian.

Ka disa tregues ose synime për të kapur shifrat diku te 1% i produktit të brendshëm bruto. Sigurisht, kjo nuk është ende në nivelet e dëshiruara, por Ministria e Arsimit ka qenë vazhdimisht në negociata me Ministrinë e Financave për t'i përmirësuar këta tregues.

Për të kaluar te pyetja e profesorit, për grantin e mësimdhënies, sigurisht që fondet për universitetet shkojnë në formë granti dhe detajohen pastaj nga bordet e universitetit, duke parë edhe vetë prioritetet. Alokimi që u bëhet fondeve është në përputhje edhe me numrin e studentëve që ka çdo universitet, por edhe me nivelin e të ardhurave të vetë universitetit. Pra, për ato universitete të cilat kanë, po themi, të ardhura më të konsiderueshme, sigurisht mbahet parasysh edhe niveli i të ardhurave në detajimin e këtij granti.

Tani, për të pasur ndoshta një nivel 100% të mbulimit për të gjitha pagat, fondi për grantin do të duhej të ishte diku te 13 miliardë, ndërkohë që ne e kemi vetëm 8,1 miliardë në total. Por, sigurisht, kjo është alternative, pasi edhe të ardhurat e universiteteve nuk është e thënë që duhet të shkojnë vetëm për pjesën akademike, por do të mbulojnë edhe këtë pjesë të të ardhurave.

Për sa u përket investimeve, në vitin 2018 Ministria e Arsimit ka mbështetur me projekte pesë universitete, ku bëjnë pjesë Universiteti i Tiranës, Universiteti i Shkodrës, Politekniku, Universiteti i Arteve dhe Bujqësores. Sigurisht, për vitin që vjen fondi për investimet ka një rritje të konsiderueshme, diku te 300 milionë, dhe universitetet, siç ishte ai i Sporteve apo edhe Universiteti i Mjekësisë, duhet të aplikojnë me projekte. Pastaj është Komiteti i Rajoneve që merr vendimin përfundimtar për t'i mbështetur ose jo këto universitete. Por, sigurisht që në objektivat dhe në prioritetet e ministrisë është që përgjithësisht kush ka aplikuar me projekte nga institucionet e arsimit të lartë ne i kemi mbështetur. Për shembull, Universiteti i Mjekësisë nuk ka pasur aplikime vitin që kaloi, prandaj edhe nuk ka përfituar.

E njëjta gjë vlen për Universitetin e Sporteve...

Jo, dakord, por...

Për sa u përket fondeve për kërkimin shkencor, aplikimet nga universitetet bëhen tek Agjencia e Kërkimit Shkencor, që është institucioni i cili merret pastaj me detajimin e fondit, sepse edhe fondet për kërkimin shkencor shkojnë në formë granti tek Agjencia. Kjo e fundit bën shpalljen e thirrjes dhe atëherë universitetet mund të aplikojnë si për projekte të mirëfillta të kërkimit shkencor, ashtu edhe për projektet që profesori i përmendi për pjesën e doktoraturës. Pra, është Agjencia e cila përcakton objektivat; kryetar bordi i agjencisë është ministria e Arsimit; profesori ose rektori i universitetit më të madh, po themi, është përsëri anëtar i bordit. Kështu që në fillim të vitit, në varësi me buxhetin, mund të përcaktohen objektivat dhe doktoraturës mund t'i lënë një fond të caktuar nga fondi total i grantit.

Gjithashtu, për pjesën e projekteve të kërkimit shkencor, është shumë e rëndësishme që universitetet të aplikojnë edhe në projektet me financim të huaj.

Për hir të së vërtetës, ka pasur mangësi. Aplikimet e universiteteve shqiptare, siç dihet tashmë, nuk kanë qenë në nivelin e dëshiruar, por në vitin 2018 ka pasur një rritje progresive të aplikimeve dhe përfitimeve që kanë pasur universitetet. Ne shikojmë vetëm financimin e huaj ose realizimin e financimit të huaj për dhjetëmujorin e vitit 2018, që e ka tejkaluar planin, pra ka

pasur progres për sa i përket realizimit të projekteve me financim të huaj, veçanërisht për kërkimin shkencor.

Nuk e di nëse...

Milva Ekonomi – Në rregull.

Po, zoti Koni.

Mynyr Koni – Në lidhje me grantin e mësimdhënies, në varësi të shifrave që ju sapo përmendët, më rezulton se është rreth 60%, ku i bie se granti i mësimdhënies që do t'u jepet institucioneve të arsimit të lartë të jetë më i vogël.

Mirela Bimo – Jo, nuk është më i vogël, granti është pothuajse në të njëjtat nivele me vitin e kaluar.

Ka universitete, pra ka institucione të arsimit të lartë, të cilat, duke qenë se të ardhurat e tyre i kanë në nivele jo siç i ka Universiteti i Tiranës, mbulimi për këto universitete bëhet në masën 100%, sigurisht me formulën e financimit, sepse formula mban parasysh disa faktorë, si: numrin e studentëve, degët prioritare ku studiojnë ata, si dhe nivelin e të ardhurave. Pra, ka edhe një faktor korrelimi, i cili e korrelojon formulën që për universitetet, të cilat nuk kanë mundësi dhe të ardhura shumë të mëdha për t'i mbuluar pagat, pjesa e grantit që akordohet për to është më e madhe.

Tek universitetet, sikurse është edhe ai i Tiranës, të cilat kanë të ardhura më të konsiderueshme, alokimi që u bëhet nga granti i buxhetit është diçka më e ulët. Pra, ka universitete, siç është ai i Sporteve, që i mbulohen ose jo në masën 100% 12 muaj ndoshta, por 11 muaj, ndërsa Universitetit të Tiranës i mbulohen 10 muaj, por jo më pak se kaq.

Edhe këtë vit situata është pak a shumë në të tilla parametra. Nuk është më e vogël.

Unë thashë që 13-miliardëshi do të duhet bashkë me orët e mbingarkesës, që ju e mbuloni totalisht me të ardhurat tuaja. Nëse do të na duhet që edhe mbingarkesën, edhe ngarkesën mësimore ta mbulojmë komplet nga granti, do të duheshin aq fonde.

Mynyr Koni – Lidhur me shqetësimin tim, si universitet, është e drejtë ajo që thotë zonja Bimo, por ashtu siç kemi të ardhurat, ashtu kemi edhe shpenzimet, sepse janë të lidhura. Të ardhurat dhe shpenzimet shkojnë në një bilanc neutral me njëra-tjetrën dhe ky është një problem që duhet parë me shumë kujdes.

Unë do të kërkoja, të nderuar deputetë, që jo vetëm për Universitetin e Tiranës, por, me sa shoh unë, ndonjë universitet nuk plotësohet, se nuk kam informacion ku i mbulon granti 100%

pagat dhe ku jo, edhe Universiteti i Tiranës me grantin që i jepet të mbulohen pagat 100%. Pjesa tjetër do të mbulohet me të ardhurat, me mbingarkesën, me aktivitetet, temat, shërbimet, me investimet e të tjerë, sepse është një problem tejet i madh dhe shumë shqetësues edhe në sytë e opinionit publik, ku të ardhurat principale që krijojnë institucionet e arsimit të lartë janë tarifat e studentëve, me anën e të cilave pjesa e mbulimit të pagave është pak e rëndë edhe emocionalisht. Kështu që do të kërkoja të gjendet mundësia që për të gjitha institucionet e arsimit të lartë, në veçanti për Universitetin e Tiranës, pagat të mbulohen nga granti i mësimdhënies.

Dua të ndalem edhe te një moment tjetër shumë i rëndësishëm, që lidhet me kategoritë e veçanta, që me vendim qeverie përjashtohen nga tarifa e shkollimit. Për Universitetin e Tiranës kjo është një gropë dhe një vlerë shumë e madhe. Ne i kemi bërë veprimet menjëherë pasi janë administruar dhe nuk janë rimbursuar. Mosrimbursimi i kësaj e ul përsëri efektin e grantit, duke çuar përsëri në uljen e të ardhurave në atë pjesë. Mund të them se studentët janë njëmijë, por nga këto njëmijë, 300 janë pjesë e këtyre kategorive të cilët përjashtohen. Në këtë aspekt këto krijojnë një hapësirë boshe në buxhetin e universitetit.

Në lidhje me çështjen e doktoraturave, ai është një element i rëndësishëm që, me të drejtë, zonja Bimo u shpreh se i takon takimit me strukturën përkatëse (AKSHI-n) për të dedikuar fondet, por nëse është e mundur, dua të di: fondi i parashikuar për vitin e ardhshëm në raport me vitin 2018 ka pësuar rritje? Nëse po, sa mund të jetë afërsisht?

Faleminderit!

Mirela Bimo – Nëse do t'i referohemi vitit të kaluar, patjetër që fondi për kërkimin shkencor ka një rritje. Pra, këtë vit është parashikuar diku te 170 milionë-180 milionë, ndërsa vitin e kaluar ka qenë më pak.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ndjesë, është 520 milionë, ndërkohë që vitin e kaluar ka qenë më pak.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, 100 milionë është financim i huaj.

Rritja është e konsiderueshme, veçanërisht, siç e përmendëm edhe më parë, te pjesa e kërkimit shkencor, kjo për shkak të ndjeshmërisë që kemi për t'i arritur ato përqindje edhe sipas përafrimit me BE-në.

Për sa i përket grantit të mësimdhënies, veçanërisht për Universitetin e Tiranës, por jo vetëm, ne jemi duke e analizuar me kujdes situatën dhe kemi në axhendë takime të veçanta me

çdo universitet, veçanërisht me bordet e administrimit, pasi, në fakt, janë pikërisht bordet e administrimit (ligji i të cilëve ka hyrë në fuqi nga viti 2015, në kuadër të reformës së arsimit të lartë) struktura përgjegjëse ligjore për pjesën e menaxhimit financiar (se është bordi i universitetit dhe administratori i tij). Sigurisht, rektorët, si titullarë të pjesës akademike, janë të përfshirë edhe në pjesën e buxhetit, por përgjegjësinë ligjore e kanë bordet e administrimit. Madje meqenëse është rasti, e mira do të ishte që rektorët të ishin këtu bashkë me administratorët për të shpjeguar më në detaje problemet financiare që mund të kenë.

Domethënë, Ministria e Arsimit ka në axhendë dhe është duke e analizuar situatën për çdo universitet, me qëllim që të evidentohen saktësisht problemet për sa i përket pjesës së menaxhimit financiar për çështjen e pagave.

Ajo që konstatojmë ne është që në disa universitete ka një raport të rritur ose të shtuar në këtë periudhë për sa i përket raportit staf akademik – staf ndihmësakademik – personel administrativ. Sigurisht, ky raport nuk mund të jetë i njëjtë për të gjitha universitetet, sepse ka universitete, si, për shembull, ai i Bujqësisë, që për shkak të specifikës që ka baza prodhuese (labororë) duhet ta kenë më të madhe pjesën e personelit ndihmësakademik, por ka universitete të tjera që nuk kanë specifika të kësaj natyre dhe këtë pjesë duhet ta kenë më të reduktuar, pasi rrjedhimisht kjo ndikon edhe te menaxhimi për sa i përket mbulimit të fondit të pagave.

Kështu, nisur nga një analizë që ne kemi bërë, rezulton se në disa universitete, të cilat nuk duhet ta kenë të rritur këtë raport, ky raport arrin edhe për 100 personel akademik, 80 ndihmësakademikë, edhe 60, edhe 50... Pra, janë shifra goxha të rritura, që, duke i krahasuar edhe me standardet ndërkombëtare, ndikojnë në performancën e çështjes së pagave. Ne jemi duke i analizuar në vijim dhe ndoshta do të kërkohet edhe një ndërhyrje në udhëzimin e ministrit për t'i përmirësuar këto raporte, me qëllim që edhe universitetet, edhe buxheti i shtetit të mos ta ndiejnë pjesën e mbulimit me paga në nivelin 100%.

Milva Ekonomi – Mund të bëjmë disa pyetje?

Kolegë, keni pyetje për të bërë?

Shoh që zoti Nasufi ka ngritur dorën, po ashtu zoti Beqiraj. Ndonjë tjetër?

(Diskutime në sallë.)

Patjetër, ja të dëgjojmë kush e do fjalën për pyetje dhe do t'jua jap fjalën.

Po, zoti Gjata.

Arben Gjata – Faleminderit!

Pa dyshim që gjatë kësaj kohe ne si universitet, sepse secili prej nesh flet për të vetin, kemi pasur të gjithë mbështetjen dhe dashamirësinë e mundshme nga Ministria e Arsimit, madje dua ta falënderoj publikisht ministren për të gjithë mbështetjen që na ka dhënë neve si universitet dhe për mirëkuptimin që ka pasur për një pjesë të problematikave, pasi në ligjin e arsimit të lartë të gjitha universitetet trajtohen njësoj. Por, në fakt, çdo universitet ka specifikat e tij.

Në qoftë se ne do të merremi me kostot, ne sot kemi tarifat e Mjekësisë, që janë 45 mijë lekë të rinj, që, në fakt, janë më pak sesa shpenzimet reale që bën universiteti qoftë për arsye njerëzore, qoftë sociale që ka Shqipëria. Ne nuk i kemi rritur tarifat e studentëve që nga viti 2013, pra i kemi mbajtur me 45 mijë lekë të rinj mjekësinë ose edhe me tarifat e tjera të mëparshme.

Është një studim, po të doni jua jap, i bërë në Vietnam, që është i ngjashëm me ne, ku shpenzimet për një student të degës “Mjekësi” në vit në Vietnam janë minimumi 1500 dollarë, aq sa shpenzojnë ata për këtë aspekt, ndërsa ne shpenzojmë më pak. Nga ana tjetër, ne kemi disa specifika, sepse, në qoftë se diskutojmë sa është personeli, sa janë ndihmësakademikë e të tjerë, çdo universitet natyrisht ka specifikat e tij. Për shembull, ne mund të kemi edhe një sekretare për një pedagog, por nuk është një sekretare për një pedagog, është një sekretare shërbimi.

Duke pasur shërbime spitalore, ai shërbimi spitalor vërtet ka një pedagog, por ka brenda 50 doktorë të punësuar, 150 infermierë, 200 të sëmurë, 50 shtretër të sëmurësh; ka për të menaxhuar të bëjë 5000 operacione në vit. Kjo sekretare që është aty nuk bën vetëm punën, sepse duke qenë shërbim universitar janë punë që mbivendosen me njëra-tjetrën. Pra, ajo bën edhe punën e sekretares për pozicionin ndihmësakademik, edhe punën e sekretares së shërbimit për të gjitha letrat, shpërndarjet, marrjen e mungesave e të tjerë. Kjo është një nga arsyet pse ne këtë vit jemi ende në periudhën e përcaktimit të strukturës së re të universitetit dhe kemi ngelur pas prej fondeve që duhet të shpenzojmë për këto raste, sepse duke caktuar sekretare për shërbim, mjekësi i rriten... Janë 42 shërbime. Minimumi i bie të ketë 42 ndihmësakademikë ose “sekretare”, siç quheshin dikur, i bie minimumi për çdo shërbim që ka QSUT-ja, që janë shërbime universitare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të kesh vërtet. Si e parashikon? E parashikon që duhet të jetë një sekretare për 21 pedagogë, pra një ndihmësakademik për 21 pedagogë. Në qoftë se do të vinim një ndihmësakademik për 21 pedagogë, i bie të kemi një sekretare për pesë shërbime universitare.

Ideja është që jo çdo gjë është..., sepse nuk është njësoj njëri universitet me një universitet tjetër. Pra, nuk është se ka punë vetëm me studentët. Një pedagog që mund të japë leksion me 150 veta dhe do të mbajë shënime, do t'ia mbajë sekretarja, ose bie fjala një departament që ka për të përgatitur pesë letra...?

Jam i sigurt se një sekretare shërbimi ka realisht shumë më tepër punë për të bërë sesa një sekretare departamenti, për shkak të specifikave që ka puna në spital.

Ju e dini shumë mirë, se keni qenë edhe zëvendësministre e Shëndetësisë në atë kohë, këtë raport dyfish që ka Universiteti i Mjekësisë me Qendrën Spitalore Universitare ose me spitalet e tjera universitare. Pra janë edhe këto problemet që sjellin këto të tjerat.

Për sa u përket fondeve të huaja, është shumë e vështirë dhe duhet të jemi realistë, sepse ne jemi ndoshta nga ato universitete që kemi marrë fonde më shumë se të tjerët. Kemi një projekt që është gati 1,2 milionë euro, që e kemi me Erasmus-in e Roterdamit, si dhe disa të tjera me shifra më të vogla.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është shumë e vështirë për një arsye. Ne nuk kemi njerëz të dedikuar që dinë të shkruajnë projekte, se nuk është edhe aq e thjeshtë të shkruash një projekt për Brukselin; një presje të mungojë, ata nuk e shohin fare projektin.

Jemi duke bërë përpjekje maksimale me universitetet partnere për ta zgjidhur, por edhe në qoftë se fiton ndonjë universitet, që të jemi realistë, te ne bien thërrimet, sepse pjesa e luanit është lideri i projektit.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Megjithatë, unë mendoj se herë pas here bordi i universitetit, edhe me ligjin e ri, ka në dorë shumë gjëra për të organizuar jetën e brendshme. Në qoftë se unë vërtet kam kontribuar pak në shërbimin shëndetësor duke pasur një post dhe e kam kuptuar diferencën që ka shërbimi spitalor nga ai universitar, kam përshtypjen se bordi duhet ta kuptojë shumë mirë që përshkrimi i detyrave është një detyrë e re edhe për bordin. Ndoshta duhet parë në këtë këndvështrim, pra nuk është vetëm një çështje që mund të ngrihet nga pikëpamja financiare.

Duhet të kemi parasysh që buxheti është ky që është dhe detyrat duhen bërë mbi bazën e tij. Ne mund të kemi qejf të bëjmë plot kërkime, mund të kemi qejf edhe të kemi një shërbim shumë të mirë, por do të bëjmë aq sa na lejon buxheti dhe cilësinë duhet ta ruajmë për karshi buxhetit.

Tani po ua jap fjalën deputetëve për pyetje dhe pastaj ministrisë, në qoftë se do të ketë ndërhyrje të tjera prej saj.

Zoti Nasufi, fjala është për ju.

Fadil Nasufi – Faleminderit, të nderuar rektorë, edhe për mbështetjen e reformës në arsimin e lartë, edhe për parashtrimet që bëtë në kuadër të buxhetit të vitit akademik 2018-2019!

Do të isha dakord që këtu të ishin prezentë edhe administratorët...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...Sepse me ligjin e ri të arsimit të lartë, drejtimi akademik është i ndarë nga drejtimi ekonomik, nisur edhe nga ndërhyrja që bëtë edhe ju, se bordet janë ato që menaxhojnë problemet financiare dhe sfidat e tjera që kanë universitetet.

Së dyti, nga pikëpamja e të ardhurave dytësore, që kanë një mbështetje për buxhetet e tyre, unë nuk besoj se universitetet janë në një stad të barabartë, qoftë nga asetet pronësore... Mund të jenë të barabartë në kuotat e pranimi të studentëve, por asetet ose mënyrat e shërbimeve që kryejnë, bie fjala Universiteti i Mjekësisë nuk mund të jetë i barabartë me atë të Inxhinierisë ose atë Bujqësor. Ministria e Financave bën një lloj diferencimi për sa i përket një kuote të të ardhurave dytësore, që siguron nga ato lloj mundësish për të siguruar të ardhura dytësore.

Në parim jam dakord që pagat duhet të jenë të garantuara, si përfaqësim të universiteteve publike, pavarësisht se në ligjin e arsimit të lartë ne kemi vendosur barazinë e universiteteve publike me ato jopublike, ku pjesën më të madhe të bordeve e zotëron ai që ka kontributin më të madh, sipas ligjit. Por, gjithsesi, me këta tregues që thonë se për nëntë muaj e gjysmë pedagogu është i garantuar me pagë, ndërsa pjesa tjetër do të jetë kështu, nuk lë shije të mirë. Kështu që, paga e garantuar si punonjës i shtetit, pavarësisht nga këto mundësi të tjera që krijohen, duhet të jetë e zgjidhur.

Për sa i përket aspektit tjetër, që e kemi diskutuar edhe në rastet e tjera, doktoraturave, edhe ligji aktual e parashikon që e drejta e profesoratit ruhet edhe për vitin sabatik, si dhe duhet zgjidhur çështja e funksionimit të shkollës së doktoraturave, ashtu siç jam edhe për një lloj rishikimi apo rifiltrimi të titujve shkencorë, sepse këta e kanë vetë në kompetencë, në bazë të autonomisë së arsimit të lartë, por që jemi përballë dy dilemave ose dy paradokseve: edhe mungesës së stafit, edhe grada e tituj shkencorë bombastikë, gati 1710 tituj nga viti 2008 në vitin

2016, por që nuk janë në akord me produktin shkencor apo edhe me përzgjedhjen kualitative të stafëve akademike ose ndihmëskademike që janë në universitetet tona.

Kjo nuk ka lidhje me buxhetin, por ka të bëjë me një lloj vëmendjeje dhe angazhimi që ato të jenë në akord me standardet e sotme të kërkesave, për t'i fituar titujt shkencorë dhe pastaj për t'u paguar në ushtrimin e profesioneve në të gjitha nivelet e arsimit të lartë.

Kjo pjesa e projekteve, aq sa është sfidë e qeverisë, është edhe detyrim i universiteteve. Ne kemi diskutuar këtu edhe për Akademinë e Shkencave, edhe për reformimin e saj të plotë, për të cilin po punohet, por këtu ka një pjesë ku kërkohen studime të mirëfillta, që mund t'i udhëheqin këto universitete. Pjesa e konkurrimit për të fituar projekte, është pjesë e sistemit dhe e garës, por, në fund të fundit, universitetet duhet të kenë edhe disa funksione të adresuara për t'i marrë, që janë edhe probleme që kërkojnë zgjidhje në planin kombëtar të disa sfidave që ka vendi ynë, sepse transformimi që ka ndodhur pas vitit 1990 ka filluar të japë edhe efektin e tij të ristrukturimit, edhe të pozicionit të ri që duhet të zënë universitetet edhe në fushën e kërkimit shkencor.

Edhe në këtë aspekt unë besoj se ka nevojë për më shumë mbështetje financiare në lidhje me laboratorët dhe teknologjinë bashkëkohore, si dhe bazës materialo-didaktike që kanë nevojë universitetet. Duhet fonde për këtë punë. Ne nuk duhet të heqim paralelizma në komente amatoreske, por studentët sot i shikon më tepër që bëjnë detyrat e kursit nëpër këto teknologjitë e aparateve dixhitale, sesa janë pjesë e asistencës pranë laboratorëve, pranë pacientëve, kur është fjala për Universitetin e Mjekësisë apo pranë studiove, kur është fjala për Universitetin e Arkitekturës apo të Ndërtimit.

Kështu, unë i mirëkuptoj rektorët. Kërkoj edhe pak më shumë mbështetje financiare nga Ministria e Financave, se edhe ai akti normativ i vitit të kaluar sikur i ka kufizuar dhe tkurrur pak këto pjesët e trashëguara të buxheteve, siç ndodh në ligjin e buxhetit, nuk mund t'i merrni më mbrapsht, pavarësisht nga procedurat e vendimmarrjes së bordeve dhe djegies së etapave. Nuk u rikthehen më, sepse fillon viti tjetër buxhetor dhe Ministria e Financave e di mirë se si vepron kur është pjesë e trashëguar e të ardhurave po, por e buxhetit jo.

Faleminderit!

Ismet Beqiraj – Tani, sigurisht që e kam të vështirë t'u bëj pyetje kolegëve të mi të universiteteve, sa u takon problemeve dhe halleve që kanë universitetet, sepse unë jam pjesë e tyre, sikurse është edhe kjo tavolinë dhe gjithë qeverisja e tanishme. Në parim unë bashkohem

me të gjitha shqetësimet që paraqitën profesorët, kolegët e nderuar, qoftë në aspektin e sigurimit buxhetor të pagave të trupës akademike, lidhur me hapjen dhe vënien në eficiencë të plotë të të gjitha akteve nënligjore që burojnë nga ligji “Për institucionet e arsimit të lartë”, sidomos për kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë. Është në të drejtën e tyre legjitime, që të kërkojnë rritje page, që së paku të njësohen me kolegët e tyre në rajon, jo më larg se me kolegët kosovarë, në mënyrë që të stimulojnë e të frenojnë braktisjen, që një pjesë e botës akademike e të kualifikuar, me doktoratura, të mos e kenë mendjen te universitetet e tjera, qoftë edhe te universitetet private këtu, sidomos stafi akademik i universitetit publik.

Nuk i diskutoj edhe shqetësimet që kanë në aspektin e infrastrukturës, qoftë dhe të auditorëve. Sikurse po ndodh edhe në arsimin parauniversitar një revolucion i vërtetë në uljen e numrit të nxënësve në klasë, në ndërtimin e shkollave të reja, edhe për ne do të jetë një ditë e lumtur të mos përsërisim shkollën e mbrëmjes edhe nëpër universitete, por ta minimizojmë sa më shumë që të jetë e mundur. Pa folur pastaj për elementë të veçantë, të cilët kanë të bëjnë me logjistikën dhe infrastrukturën e kërkimit shkencor, dhe me mësimdhënien shkencore, pra me laboratorët.

Megjithatë, le ta pranojmë: qeveria këtë kuletë ka. E rëndësishme është që të miradministrohen dhe të shfrytëzohen të gjitha burimet. Me autonominë që i ka dhënë arsimit të lartë, ligji ua ka dhënë këtë mundësi të gjitha institucioneve, sidomos atyre publike. Në parantezë, do të thosha se ne, si komision që japim mendim, duhet t’i mbështesim fuqimisht institucionet e arsimit të lartë, sepse investimi në këtë sektor është si puna e asaj pemës që mbjellim sot, por që frutat ia merr jo me javë e muaj, por i merr me dekada e shekuj me radhë.

Pra, investimi më i mirë është investimi në arsim. Sinqerisht, kur shikoj te fondet e Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë, ku planifikimi zë gati 0,46 % të GDP-së ose 1,24 % të shpenzimeve publike, shikoj vëmendjen e qeverisë, por në fund të dëgjësave, edhe ne si komision do të dalim me një vendim, që t’i mbështesim sa më shumë në çështjet e tyre më prioritare.

Në vijim, nuk do t’i drejtohem drejtpërdrejt e në mënyrë nominale ndonjë kolegu, por do të bëj disa pyetje.

Sikurse u tha, për këtë vit, buxheti i dedikuar arsimit të lartë është gati rreth 3,7 % më i lartë, në krahasim me vitin 2018. Po kërkesat tuaja për t’u mbështetur financiarisht nga buxheti i shtetit për 2019-ën, sa për qind zënë krahasuar me 2018-ën?

Pyetja e dytë. Shoh se në këtë vit buxhetor, buxheti i 2019-ës për kërkimin shkencor ka një rritje prej gati 29 %, krahasuar me 2018-ën. Rritja e fondeve për kërkimin shkencor, është një gjë për të cilën deri para disa kohësh, as nuk bëhej fjalë në institucionet e arsimit të lartë. Tani, sa për qind e fondeve për kërkimin shkencor janë bërë eficiente për vitin që po kalojmë dhe a keni kritere për performancën e këtyre fondeve? Sepse jepen fondet, por nuk ka aplikim, nuk ka cilësi në projektet që aplikohen.

E treta. Në objektivat qeveritare për periudhën 2019 – 2021, është përcaktuar që 95 % e doktorantëve të jenë pjesë e stafëve akademike. Po sot, si është situata? A mund të arrihet ky objektiv?

Pyetja e fundit, por jo më pak e rëndësishme, është kjo: edhe gjatë studimit që i kam bërë projektbuxhetit të paraqitur, nuk kam parë kërkesa në lidhje me infrastrukturën e mësimdhënies. A mos është harruar projekti i të famshmit kampus universitar?

Faleminderit!!

(Ndërprerje e shkurtër incizimi.)

Arben Gjata – Atëherë, po përgjigjem për veten time, sepse çdo njeri përgjigjet për veten e vet.

Të gjitha paratë që kanë marrë universitetet deri vjet, i kanë marrë në formë granti. Ai që ka vendosur se si do ta ndajë grantin, se sado të ishin për kërkim shkencor, sa do të ishin për pagesa, sa do të ishin për tjetër gjë, ka qenë bordi i universitetit. Natyrisht, bordi i universitetit ka shumë detyra dhe shumë rëndësi përbrenda universitetit, por duhet të kuptojmë se edhe bordet e universitetit, edhe kancelari, edhe administratori veprojnë mbi bazën e kërkesave që ka ana akademike, se ata s'i ka vënë njeri aty që të bëjnë buxhetin. Nuk mund ta bëjë buxhetin administratori. Administratori do ta bëjë buxhetin mbi bazën e kërkesave që kanë departamentet, shërbimet, mbi bazën e prioritetëve akademike që përcakton universiteti. Nga ana ligjore ai e bën, por nuk mund të jetë njeriu vendimmarrës, për të vendosur se ku do të shkojnë paratë. Madje as administratori e as bordi i administrimit, që të jemi të qartë.

Kështu funksionon në të gjithë botën. Edhe aty ku funksionojnë bordet, bordi merr prioritetin që ka një universitet, dhe i çon paratë sipas prioritetëve që ka universiteti, jo sipas prioritetëve që ka bordi. Po flasim për bordin, ku janë ca burra me mjekër të bardhë, të cilët vënë emrin e tyre në lojë kur hyjnë nëpër bordet e atyre universiteteve të famshme. Nuk po flasim për bordet e universiteteve shqiptare. E para kjo.

E dyta, në qoftë se vjet do të jepnim grant për kërkimin shkencor, me çfarë do t'i paguanim rrogat e pedagogëve?

Pra, historikisht, me vite të tëra, në të gjitha universitetet, ose të paktën në Universitetin e Mjekësisë, qëkurse është krijuar, por me sa di unë edhe në shumicën e universiteteve, duke qenë se paratë që merr universiteti në formë granti, nuk arrijnë të plotësojnë nevojat për pagesën e rrogave, të gjitha paratë që merren andej, shkojnë kryesisht për pagesën e rrogave. E gjithë pjesa tjetër e parave që merr universiteti janë investime, prej të cilave një pjesë shkon si pagesë për pjesën tjetër të rrogave që ngelen pa u paguar, e kështu mbushet një qind për qind pagesa e rrogave të pedagogëve efektivë, shkojnë për pagesën e orëve pedagogjike të pedagogëve të jashtëm, si dhe për atë mbingarkesë, që vjet përfshinte deri në 30 % të pedagogëve të brendshëm që bënin orë suplementare. Pjesa tjetër që mbetet, pasi shkarkohen këto, investohet nëpër departamente, sipas kërkesave që ato kanë.

Ndërkohë, të bësh një investim të madh brenda universitetit, duke filluar që nga kampusi, është e pamundur që me të ardhurat e universitetit të bësh një investim të madh. Kjo sepse paratë që ngelen, janë një sasi e tillë, sa për të bërë *runin cost*, siç quhet ndryshe, pra për të paguar dritat, për të lyer muret me bojë, për të bërë një aktivitet për studentët, siç mund të jenë temat e diplomimit, për të bërë mbështetje të konferencave shkencore e të tjera.

Te mjekësia, pjesa e kërkimit shkencor, zakonisht është bërë nga vetë ata që kërkojnë. Natyrisht, janë shfrytëzuar ato mundësi që na ka dhënë të qenit pjesë përbërëse e Qendrës Spitalore Universitare. Pra, kryesisht janë studime klinike që janë marrë me pacientët, si kanë shkuar, çfarë problemesh kanë pasur. Analizat që janë pjesë e këtyre studimeve janë ekzaminimet rutinë që u bëhen pacientëve brenda spitalit. Fatmirësisht, është ajo pjesa që ne ia marrim spitalit dhe nuk ia paguajmë, të cilën e përdorim për kërkime shkencore. Pra, kryesisht janë studime klinike. Në Shqipëri duhet tjetër infrastrukturë për të bërë studime, *research* themelor, *research* bazik. Duhet laboratorë supermoderne, duhet njerëz të supertrajnuar, duhet shumë investime, gjëra të cilat besoj se nuk kemi për t'i pasur edhe për shumë vite. Kjo, sepse nuk do të kemi mundësi financiare, laboratorike e njerëzore, që të bëjmë *research* bazë, të thelluar. Duhet të jemi realistë dhe ta shohim të vërtetën në sy. Në qoftë se ne shohim ëndrra në diell, se nesër do të bëjmë një zbulim dhe do të shpikim se si shërohet kanceri apo si luftohet një sëmundje e rrallë, detyra jonë, të paktën në mjekësi, është që ato që bën dynjaja të mund t'i zbatojmë këtu, t'i vëmë në përdorim të njerëzve, që të përfitojmë e të ecim hapin e me ritmin që

ecën e gjithë bota në fushën e mjekësisë. Besoj se kjo është thelbësore për ne, sepse nuk kemi as mundësi financiare, as njerëzore, as kapacitete njerëzore, as kapacitet laboratorik, që të bëjmë kërkime bazike, të thelluara, që t'i ndajmë gjërat.

Ne mund të bëjmë sa të duam kërkime të karakterit klinik, të cilat tregojnë se cila është metoda më e mirë apo më e keqe, cila mund të përshtatet më mirë në kushtet e Shqipërisë. Natyrisht, kemi shumë mundësi të bëjmë studime epidemiologjike, për të parë se si është sëmundshmërie në vend, çfarë prioritetesh mund të ketë. Natyrisht, kemi shumë mundësi t'i japim rekomandime qeverisë shqiptare, në kuadër të projekteve për zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të mjekësisë shqiptare, siç e kemi bërë pa pagesë në universiteti, projekti për zhvillimin e kirurgjisë në rang vendim, me propozime për krijimin e spitaleve, qoftë të spitaleve ditore, qoftë të spitaleve rajonale, qoftë për forcimin e QSUT-së e të tjera. këto studime mund t'i bëjmë. Është fjala për këtë kategori studimesh.

Në qoftë s flasim për grantet, që është i pasqyruar te projekti, unë jam absolutisht dakord me atë që është në ligj e me atë udhëzim. Çdo departament duhet të ketë disa projekte të mëdha, të cilët duhet të kenë impakt social dhe impakt në zhvillimin e vendit. Atëherë. mbi bazën e këtyre projekteve mund të dalin doktoratura të veçanta. Sepse shpeshherë, tek ne ka ndodhur që është bërë doktoraturë për doktoraturë. Ka pasur një temë, ka pasur qejf ta bëjë, ka paguar lekët, ka bërë temën, ka marrë atë titull. Se kujt i ka hyrë në punë ajo doktoraturë, në çfarë pjese të shoqërisë shqiptare ka hyrë në punë kjo doktoraturë, kjo është çështje diskutimi.

Në qoftë se do të diskutojmë, siç u fol këtu më parë, për rishikimin e titujve ose të gradave, në të gjithë botën një gjë e tillë nuk bëhet me vullnet politik, por me vullnet ligjor. Deri më sot, në Shqipëri nuk kemi ndonjë mekanizëm, i cili të jep mundësinë të bësh rishikim të gradave apo titujve. Një njeriu që ka marrë një titull ose një gradë akademike, në qoftë se nuk ka mekanizëm ligjor për të ngritur një komision, kush do t'ia heqë titullin? Kush mund t'ia heqë? Në kushtet që jemi sot, askush. Kjo kërkon një ndryshim total ligjor. Sot edhe nëse duam të heqim një doktoraturë, po pati kaluar në komision nuk e hiqni dot, të jeni të sigurtë për këtë, edhe sikur të mos na pëlqejë fare. Kjo sepse ligji ia ka dhënë komisionit të vlerësimit të doktoraturës të drejtën për t'i dhënë titullin, për t'i dhënë doktoraturën. Në qoftë se ka kaluar në atë komision dhe ka marrë titullin, unë mund të jem rektor universiteti, mund të mos më pëlqejë fare doktoratura, por askush nuk ma njeh të drejtën ligjore e as kapacitetin profesional, që të

them: jo, ky person nuk duhet ta marrë, kjo doktoraturë s'është e mirë, pse e keni kaluar ju? Sepse autonomia këtë kupton.

Pra, kjo kërkon një tjetër proces, të tjera mekanizma, të cilat sot nuk ekzistojnë brenda legjislacionit shqiptar, që të jemi të qartë, me përjashtim të plagjiaturave. Natyrisht, në rast plagjiature mund të hiqen.

Mangësi ka. Është e mirë, s'është e mirë, është e vlefshme, s'është e vlefshme, është e bukur, është e shkruar, etje, me një fjalë mungon një bazë ligjore në këtë mes.

Mos lashë ndonjë gjë pa përgjigje?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Përgjigje të tjera shteruese?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Nuk mora përgjigje, të them të vërtetën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ah, më falni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mynyr Koni – Profesor Ismeti, faleminderit për pyetjet që bëtë për ne drejtuesit e institucioneve!

Së pari, në lidhje me kërkesën për rritje, edhe në komunikimin tim të parë e thashë se, përderisa kemi kërkuar rritjen e fondit të pagave, i bie të kemi kërkuar një rritje të grantit për 20 –25 % të asaj që i jepet institucionit.

Ashtu sikundër u përmend nga kolegët, ky grant ndahet për fondin e pagave, për sigurimet dhe për mbështetjen studentore. Asgjë tjetër. Kjo mbulon rreth 70 – 89 % të të gjithë aktivitetit vjetor.

Së dyti, në lidhje me pyetjen se sa fonde kemi përdorur për kërkimin shkencor, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe e Teknologjisë së Informacionit ka shpallur një thirrje në korrik të këtij viti, dhe Universiteti i Tiranës ka paraqitur 18 projekte. Jemi në pritje të vlerësimit të tyre, për ta bërë eficient këtë fond nëpërmjet projekteve.

Në lidhje me pyetjen që ka të bëjë me çështjen e kampusit, nga ana e institucionit është paraqitur në Fondin e Zhvillimit të Rajoneve një projekt për implementimin e tyre.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Zoti Agron, po ju, keni nevojë të shtoni diçka?

Mirlinda Galushi – Unë jam Mirlinda Galushi, administratore te Universiteti i Sporteve.

Duke qenë se u kërkua në përqindje se sa kërkesa kemi bërë ne, po këmbëngulim te pjesa e investimeve, sepse me thënë të drejtën, nuk kemi pasur probleme te pjesa e pagave.

Te pjesa e investimeve kemi projekte të gatshme. Është projekti i pishinës, në lidhje me të cilin kemi vite që kemi aplikuar. Është projekti i shtesës së palestrës së gjimnastikës. Së fundi, po bëhet gati edhe projekti i fushës së futbollit dhe pjesës së atletikës.

Këta tre projekte janë prioritet të miratuara në strategjinë e universitetit, të miratuara në senat dhe në bordin e administrimit, si dhe që janë aplikuar edhe në projektbuxhetin e këtij viti. Po ta llogaris në përqindje, të themi të drejtën ne e kemi parashikuar pishinën në trevjeçar, por nëse llogariten në 2019-ën i bie të zërë gati 75 % të këtyre fondeve që janë në investime.

Gjithsesi, te pjesa e pishinës, që është një fond goxha i madh, ne e kemi lënë të shtrirë në tre vjet. kemi lënë edhe një fond i cili, duke qenë se aplikohet në fondet e zhvillimit e në vendim qeverie thuhet e 30 % e këtyre duhet të financohen nga të ardhurat e universitetit. Këtë gjë e kemi parashikuar në projektbuxhetin e këtij viti, për të qenë të gatshëm që të aplikojmë përsëri me këto projekte që i kemi gati.

Realisht janë projekte të mëdha, të cilat duan financim të madh, por në qoftë se duam që të bëhet në total kampusi i universitetit të sporteve, që është i vetmi në Shqipëri, këto janë kryesoret për ne si universitet.

Kaq kisha.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Zonja Mirela, po vjet, ose në vitin shkollor 2017 – 2018, si kemi qenë? A e ka marrë pagën i gjithë profesorati? Kanë marrë dhjetë muaj, njëmbëdhjetë muaj, dymbëdhjetë muaj?

Mirela Bimo – Sikurse e theksuam edhe më parë, vendimi i Këshillit të Ministrave parashikon një formulë që përshkruan mënyrën e shpërndarjes së grantit. Formula merr në konsideratë disa elementë, të cilët janë numri i studentëve, degët në të cilat ata studiojnë. Ka edhe një koeficient për çdo universitet, në varësi të specifikave çdo universitet. Formula merret në konsideratë edhe nivelin e të ardhurave që sigurojnë universitetet. Ka edhe një koeficient korrelimi.

Ne e përmendëm se ka universitete, sikurse është edhe Universiteti i Sporteve, meqë është këtu, që i mbulohet niveli i pagave, pra mësimdhënia në nivelin 100 %. Mund të them se

Universiteti i Tiranës është i vetmi, duke qenë se koeficienti që merr parasysh formula, është niveli i të ardhurave, dhe niveli i të ardhurave të universiteti i Tiranës është më i lartë se në çdo universitet tjetër. Prandaj, të ky universitet pjesa e financimit që bën granti është më i ulët, pra nuk i mbulon 100 %. Ka universitete të tjera, siç është ai i Sporteve, siç është Bujqësori, siç është Universiteti i Arteve apo ai i Shkodrës, që e kanë plotësisht të mbuluar pjesën e të ardhurave, për shkak të këtij elementi, që është niveli i të ardhurave. Jo më kot, në Universitetin e Tiranës, në qoftes e do të marrim parasysh kompozimin e bordit, pjesa më e madhe e anëtarëve janë nga universiteti, pikërisht për shkak të nivelit të të ardhurave që ata kanë. Pra, është element i ligjit edhe ky, që ata universitete që kanë të ardhura më shumë, që kontribuojnë më shumë me të ardhura se sa kanë mbështetjen buxhetore... Domethënë, kjo ndikon edhe te struktura e bordit.

Sigurisht, nëse mundësia e buxhetit do të ishte më e madhe, patjetër që universiteteve do të arrihej t'u mbulohejshin të gjitha. Vlen të theksohet, pra më lejoni ta përmend, se që nga viti 2013, niveli i tarifave të studentëve në institucionet e arsimit të lartë ka ngelur i pandryshuar. Pra, ka një rritje me zero lekë të tarifave të studentëve.

Sigurisht, nëse ky nivel tarifash do të ishte rritur, edhe të ardhurat e universiteteve do të ishin më të larta, për shkak edhe të propozimeve që kanë bërë vetë institucionet e arsimit të lartë, pra që e kanë mbajtur të pandryshuar nivelin e tarifave. Mbase do të duhej që kontributi nga buxheti i shtetit të ishte më i madh, por kjo është në varësi të parametrave makroekonomikë e financiarë të buxhetit.

Arben Gjata – T'ju jap një shembull: në vitin 2005, tarifa që paguante një student, i cili hynte në Universitetin e Mjekësisë, në Fakultetin e Mjekësisë, ishte 40 mijë lekë të vjetra ose 4 mijë lekë të reja. Në vitin 2013 tarifa ishte 45 mijë lekë të reja ose 450 mijë lekë të vjetra. Pra, në tetë vjet është rritur më shumë se dhjetëfish tarifa e studimit. Pikërisht për shkak të këtij reaksioni që kishte sjellë, shumica e universiteteve vendosën që të mos i rrisnin tarifat e studimit.

Sa për rrogat, po ju jap edhe një sqarim tjetër: rrogat e pedagogëve të universiteteve në Shqipëri, kanë pasur rritje në vitin 2004, kur me vendim qeverie u dyfishuan rrogat. Më pas, deri vjet, që është bërë rritja 10 % e rrogave të pedagogëve të universiteteve publike në vend, rroga ka ardhur duke u ulur nga viti në vit.

Nga qeveritë nuk është marrë asnjëherë në konsideratë në rregullimin e koeficienteve, kur bënin rritje 1 %, 2 %, 3 %. Rritej taksimi, dhe të ardhurat reale që ne kemi çuar në shtëpi deri

vjet, kohë kur u rrit me 10 % granti i rrogave, të gjithë pedagogët e universiteteve janë paguar më pak se 2004-a, që t'i keni të qarta këto gjëra.

Milva Ekonomi – Po, Fidel

Fidel Ylli – Gjithmonë, kur flasim për buxhetin, të gjitha institucionet që vijnë këtu kërkojnë me të drejtë shtesa buxheti. Unë dua të ndalem në një pikë që pak a shumë e njoh mirë e që më djeg një çikë më shumë. Do të doja që të gjitha institucionet, sidomos universitetet, të kishin palestra, të kishin terrene sportive për të zhvilluar orën e edukimit fizik, që gjatë këtyre viteve pothuajse është shuar fare. Ne bëmë një ligj shumë të mirë për orët e mësimin nëpër shkolla, kemi krijuar edhe Federatën e Universiteteve e të shkollave të mesme.

Do të thosha që, në rast se një universitet kërkon një auditor për të zhvilluar leksionet, Universiteti i Sporteve nuk ka kuptim fare pa terrene sportive.

Prandaj, do t'i lutesha ministrisë, që ta shohë me vëmendje këtë kërkesë të bërë nga rektorati i Universitetit të Sporteve, për fushën e atletikës, për fushën e futbollit, për shtesën e palestrës e të pishinës, sepse në rast se nuk janë terrenet sportive në këtë universitet, ai universitet nuk bëhet vetëm me teori edukimi, por do praktikë. Pra, sporti është terren, është aktivitet, është pallat sporti, është stadium, është pistë atletike.

Do t'ju lutesha shumë, zonja Mirela, që ta shikoni edhe me ministren. Ndoshta mund të duhet edhe ndonjë mbështetje pranë qeverisë për nxjerrjen e një buxheti të veçantë, që këto projekte të realizohen.

Do të doja t'i thosha rektorit të universiteteve, që është krijuar një federatë e universiteteve, që duhet të funksionojë, pasi shoh se nuk ka lëvizje, nuk ka gjallëri për të kryer ato universiadat e famshme, që janë kryer, për të furnizuar gjithashtu dhe ekipet tona kombëtare.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Në rregull!

Ne ju dëgjuam, kuptuam se keni nevojë për rritje granti dhe rritje investimesh te Universiteti i Sporteve. Besoj se edhe kolegët i morën shënim këto gjëra. Pasi të mbarojmë të gjitha dëgjesat edhe me shoqërinë civile nesër, do të ulemi si komision, për të bërë raportin tonë final të dëgjesave dhe për ta kaluar te Komisioni i Ekonomisë mendimin tonë për këtë projektbuxhetin.

Nuk dimë t'ju themi tani se cila nga këto kërkesa do të merret në konsideratë, sepse kjo kërkon edhe një diskutim të brendshëm mes nesh. Padyshim që i kemi të shënuara dhe do të shohim se çfarë do të propozojmë.

Ju faleminderit shumë! Shumë suksese për këtë vit akademik, që sapo ka filluar dhe doktorantë të mbarë!

Mbas pak, në orën 13.00 do të kemi universitetet e rretheve.

MBYLLET MBLEDHJA